REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE / MUNICIPALITY OF GJILAN / GILAN BELEDIYESI

ZYRA E KRYETARIT
KANCELARIJA PRESEDNIKA / MAYOR'S OFFICE / BASKAN OFISI

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040, nenit 78 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Gjilanit 01. nr. 016-126211 dt. 06.11.2014, me ndryshimet dhe plotësimet në Statut 01. nr. 016-28448 të datës 22.03.2018, Kryetari i Komunës së Gjilanit nxjerr këtë:

**U R D H Ë R E S Ë**

**për**

**Ndalimin e përdorimit të produkteve piroteknike (fishekzjarrëve)**

1. **NDALOHET** përdorimi i produkteve piroteknike/fishekzjarrëve në vendet e hapura publike, (përkatësisht në tregje, rrugë dhe sheshe).

2. Ndalesa sipas pikës 1 (një) të kësaj urdhërese, vlen për periudhën prej 20 Dhjetor 2024 deri më 03 Janar 2025.

3. Personat të cilët veprojnë në kundërshtim me dispozitat e kësaj urdhërese, do të gjobiten në shumë prej 100 euro.

4. Për zbatimin e kësaj urdhërese kujdeset Drejtoria e Inspeksionit dhe Policia e Kosovës.

5. Kjo urdhëresë hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj.

**Urdhëresa i dorëzohet:**

**1. Drejtorisë së Inspeksionit**
**2. DSHPIB-së,**
**3. Policisë së Kosovës dhe**
**4. Arkivës Komunale.**

**Kryetari i Komunës**

**Alban Hyseni**